



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 6 korrik 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim i dytë kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Huper

**Mbrojtësit të viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 22(1), 34(6), 39(1) dhe (13) të Ligjit mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 23(5), 95(2)(i) dhe 113 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat (“Vendimi i Parë Kornizë”), ku, ndër të tjera, i jepte urdhër Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) që brenda datës 15 shkurt 2021, në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, t’u paraqiste Gjykatësit të Procedurës paraprake dhe palëve raportin e parë lidhur me kërkesat e dorëzuara si dhe të paraqiste periodikisht raporte të mëtejshme, nëse do të kishte, jo më vonë se dorëzimi i parashtrimit të Mbrojtjes në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores.<sup>2</sup>
2. Më 15 shkurt 2021, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të parë mbi kërkesat e ardhura (“raporti i parë”).<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat (“Vendimi Kornizë”)*, 4 janar 2021, publik, para. 56(c)-(e).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00203, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Raporti i parë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces*, 15 shkurt 2021, publik, para. 8, me shtojcat konfidenciale dhe *ex parte* 1-19. Mbrojtja e z. Thaçi, Mbrojtja e z. Krasniqi dhe ZPS-ja parashtruan përgjigjet. *Shih* F00208, Mbrojtja e z. Thaçi, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj raportit të parë të Zyrës Administrative mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces*, 26 shkurt 2021, publike; F00209, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Përgjigjja e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj raportit të parë të ZPV-së*, 1 mars 2021, publike, me shtojcën 1, publike; F00210, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë mbi raportin e parë të Zyrës Administrative mbi kërkesat e viktimave*, 1 mars 2021, publik.

3. Më 1 prill 2021, ZPV-ja parashtroi një shtesë të raportit të parë ku jepte rekomandimet e saj për ndarjen në grupe të parashtruesve të kërkesave.<sup>4</sup>
4. Më 16 prill 2021, ZPV-ja parashtroi një kërkesë për autorizim për të përdorur një formular elektronik të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë (“kërkesa e ZPV-së”).<sup>5</sup>
5. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë mbi pjesëmarrjen e viktimave.<sup>6</sup>
6. Më 3 maj 2021, Mbrojtja e Kadri Veselit (“z. Veseli”) iu përgjigj kërkesës së ZPV-së.<sup>7</sup>
7. Më 11 maj 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së Mbrojtjes së z. Veseli.<sup>8</sup>
8. Më 18 qershor 2021, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të dytë mbi kërkesat e ardhura (“raporti i dytë”).<sup>9</sup>

---

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00241, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Shtesë e raportit të parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces me rekomandim për grupim*, (“Shtesa”), 1 prill 2021, publike, me shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00252, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Kërkesë për autorizim për të përdorur një formular elektronik të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë*, (“Kërkesa e ZPV-së”), 16 prill 2021, konfidenciale dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00252/RED, *Version i redaktuar publik i kërkesës për autorizim për të përdorur një formular elektronik të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë*, 23 prill 2021, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 21 prill 2021, konfidencial. Shih gjithashtu F00257/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 21 prill 2021, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC 2020-06, F00273, Mbrojtja e z. Veseli, *Përgjigjja e Mbrojtjes së Veselit ndaj parashtrimit të protokolluar të Zyrës Administrative KSC-BC-2020-06/F00252-RED* (“Përgjigjja e Veselit”), 3 maj 2021, publike.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00288, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigjja e Prokurorisë për përgjigjen e Mbrojtjes së Veselit ndaj parashtrimit të protokolluar F000252* (“Kundërpërgjigjja e ZPS-së”), 11 maj 2021, publike.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00360, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Raporti i dytë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces*, 18 qershor 2021, konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-12, konfidenciale dhe *ex parte*.

## II. PARASHTRIMET

9. ZPV-ja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të lëshojë një autorizim për përdorimin e një formulari elektronik të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë që mund të shkarkohet dhe plotësohet elektronikisht (“formulari i propozuar”).<sup>10</sup> ZPV-ja parashtron se përdorimi i formularit të propozuar është i nevojshëm për shkak të vështirësive të lidhura me sigurinë dhe pandeminë e KOVID-19 për shtypjen në letër dhe nënshkrimin me dorë të formularit aktual të kërkesës që gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara (“DHSK”) (“formulari i kërkesës”).<sup>11</sup> ZPV-ja gjithashtu parashtron që kutia ku vihet nënshkrimi në formularin aktual të kërkesës, në formularin e propozuar do të hiqet dhe do të zëvendësohet me një hapësirë që përmban një zotim solemn, që do të plotësohet duke shtypur në kompjuter emrin e parashtruesit të kërkesës.<sup>12</sup> Pasi të plotësohet, formulari i propozuar do të dorëzohet në mënyrë konfidenciale përmes faqes në internet të DHSK-së, duke përdorur një mekanizëm të sigurtë dërgimi.<sup>13</sup> ZPV-ja më tej bën të ditur se, për të siguruar që personi i cili dorëzon kërkesën të mund të identifikohet në mënyrën e duhur, parashtruesit e kërkesave do të duhet të dërgojnë një kopje të një dokumenti identifikimi.<sup>14</sup> Sipas ZPV-së, ndërthurja e pjesës së zotimit solemn dhe e dëshmisë së identitetit do të ofrojë një mënyrë të besueshme për garantimin e vërtetësisë së kërkesave.<sup>15</sup> ZPV-ja parashtron se formulari i propozuar do të përdoret përjashtimisht, vetëm në ato raste kur dorëzimi i kërkesës në mënyrën e zakonshme nuk do të mund të kryhet për shkak të rrethanave.<sup>16</sup>

---

<sup>10</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 15-16.

<sup>11</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 10-11.

<sup>12</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 16.

<sup>13</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 16.

<sup>14</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 17.

<sup>15</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 17.

<sup>16</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 18.

10. Mbrojtja e z. Veseli pranon se mund të krijohen rrethana vërtet të jashtëzakonshme të cilat pengojnë parashtruesin e kërkesës për pjesëmarrje si viktimë të vendosë fizikisht nënshkrimin e tij apo të saj në formularin e tanishëm. Rrjedhimisht, Mbrojtja e z. Veseli në parim nuk kundërshton përdorimin e formularit të propozuar në ato raste kur është absolutisht e domosdoshme dhe kur plotësohen këto dy kritere: (i) zotimi solemn i propozuar në formularin e propozuar të përfshijë tekst sipas të cilit parashtruesit të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë i kërkohet të konfirmojë se është në dijeni të pasojave ligjore nëse jep informacion të rremë si në shtetin ku banon ashtu edhe para Dhomave të Specializuara; dhe (ii) formulari i propozuar detyron parashtruesin e kërkesës për pjesëmarrje si viktimë të përshkruajë “rrethanat e jashtëzakonshme” që e pengojnë atë të vendosë fizikisht nënshkrimin në kërkesë.<sup>17</sup>

11. ZPS-ja kundërpërgjigjet duke parashtruar se formulari elektronik i kërkesës duhet të lejohet të përdoret sa herë që shfaqen vështirësi praktike dhe rreziqe për sigurinë dhe se kriteri i “rrethanave të jashtëzakonshme” nuk është i domosdoshëm.<sup>18</sup> Sipas ZPS-së, dëshmia e identitetit, së bashku me konfirmimin solemn dhe rolin ndërveprues dhe qendror të ZPV-së që, ndër të tjera, siguron që formularët e kërkesave të jenë të plotë dhe jep rekomandimet e saj për pranueshmërinë e tyre, janë garanci më se të mjaftueshme për vërtetësinë.<sup>19</sup> ZPS-ja më tej parashtron se ZPV-ja, në këshillim me parashtruesin e kërkesës për pjesëmarrje si viktimë, është në një pozitë më të mirë për të përcaktuar dhe konfirmuar nëse rrethanat arsyetojnë përdorimin e formularëve elektronikë të kërkesave.<sup>20</sup>

---

<sup>17</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 14-15.

<sup>18</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 3.

<sup>19</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2.

<sup>20</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 3.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Sipas nenit 34(6) të Ligjit dhe rregullës 23(5) të Rregullores, ZPV-ja, ndër të tjera, administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave siç parashikohet në nenin 22 të Ligjit dhe në Rregullore. ZPV-ja ndihmon dhe këshillon viktimat pjesëmarrëse në proces ("VPP").

13. Sipas rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon ato Gjykatësit të Procedurës Paraprake së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe për kërkesën për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit.

### IV. DISKUTIM

14. Në këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake trajton: (i) një numër çështjesh që janë theksuar në parashtrimet e raportit të parë dhe raportit të dytë; dhe (ii) përdorimin në të ardhmen të një formulari elektronik për parashtrimin e kërkesave të viktimave në të ardhmen.

#### A. SQARIME LIDHUR ME PROCESIN E PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE NGA VIKTIMAT

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paraqitja e raportit të parë ka nxjerrë në pah një numër çështjesh, disa prej të cilave janë trajtuar shkurtimisht në vendimin e parë mbi pjesëmarrjen e viktimave dhe të cilat shtjellohen edhe në këtë vendim, duke marrë parasysh edhe raportin e dytë. Këto çështje kanë të bëjnë me: (i) informacionin që ZPS-ja duhet t'i japë ZPV-së në lidhje me personat që kanë pësuar dëm; (ii) informacionin që duhet t'u jepet atyre që dëshirojnë të parashtrojnë kërkesa; (iii) dokumentacionin që kërkon ZPV-ja për dorëzimin e kërkesave; dhe

(iv) parashtrimet e ardhshme të ZPV-së lidhur me ndarjen në grupe dhe përfaqësimin juridik të parashtruesve të kërkesave.

## 1. Parimet që rregullojnë procesin e parashtrimit të kërkesave

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se me vendimin e parë kornizë ai lejoi ZPV-në të ketë qasje në versionet e paredaktuara të Aktakuzës së Konfirmuar<sup>21</sup> dhe në vendimin e konfirmimit<sup>22</sup> dhe udhëzoi ZPS-në që t'i jepte ZPV-së emrat e të gjithë personave që kishin pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përshkruar në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>23</sup>

17. Duke pasur parasysh faktin që në parashtrimet e lartpërmendura ZPV-së i bëhen të ditur emrat e viktimave të mundshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake saktëson se informacioni që ZPS-ja duhet t'i japë ZPV-së për çdo person që ka pësuar dëm duhet të përmbajë, për aq sa është e mundur, të dhënat e kontaktit të atyre personave në mënyrë që t'i mundësojë ZPV-së të kontaktojë me ta. Gjithashtu, ZPS-ja duhet t'i japë ZPV-së çdo informacion ose rekomandim tjetër të nevojshëm në lidhje me sigurinë e parashtruesve të kërkesave, që ZPV-ja të mund të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë të plotë dhe me vëmendjen e duhur ndaj aspekteve mbizotëruese të sigurisë.

## 2. Informacioni që u jepet personave që duan të parashtrojnë kërkesë

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton dhe thekson rolin qendror që luan ZPV-ja në procesin e parashtrimit të kërkesave dhe se, si rrjedhojë e atij roli, është

---

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>22</sup> KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>23</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 14-15.

prerogativë dhe përgjegjësi e ZPV-së t'u ofrojë personave që duan të parashtrinë kërkesa informacion në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe kornizën për pjesëmarrjen e viktimave dhe, nëse është e nevojshme, të ndihmojë këta parashtrues kërkesash në plotësimin e formularit përkatës.<sup>24</sup> ZPS-ja dhe njësitë e tjera të Zyrës Administrative mund të ofrojnë ndihmë në këtë proces, në bashkërendim me ZPV-në.

### 3. Dorëzimi i kërkesave

19. Sa i përket dorëzimit të kërkesave nga ZPV-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij në vendimin e parë kornizë, sipas të cilit një kërkesë është e plotë nëse përmbush këto kritere: (i) ka prova të mjaftueshme për identitetin dhe, nëse ka lidhje, për lidhjen familjare dhe/ose kujdestarinë ligjore; (ii) të dhënat personale janë të plota; (iii) të gjitha pjesët e formularit të kërkesës janë plotësuar<sup>25</sup>; (iv) data/periudha dhe vendndodhja e krimeve si dhe dëmi i pësuar janë shënuar mjaftueshmërisht qartë; (v) është paraqitur dokumentacion i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm për atë që ka qenë e mundshme; dhe (vi) kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose nga kujdestari ligjor i tij/saj.<sup>26</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej rikujton udhëzimin e tij se ZPV-ja duhet të bëjë përpjekje për të dorëzuar vetëm kërkesa të plota.<sup>27</sup>

20. Sikurse theksohet në vendimin e parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, udhëzimet e lartpërmendura nënkuptojnë që ZPV-ja gjithmonë duhet të kërkojë informacion nga parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje si viktimë nëse dokumentacioni i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm në mbështetje të kërkesës së tyre është i disponueshëm dhe, nëse po, ZPV-ja duhet të kërkojë dorëzimin e atij materiali.<sup>28</sup>

---

<sup>24</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 16.

<sup>25</sup> Formulari "Kërkesë për praninë si viktimë pjesëmarrëse në proces gjyqësor", që gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

<sup>26</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 22.

<sup>27</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 23.

<sup>28</sup> Vendimi i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 35 dhe poshtëshënimi 26.



Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej thekson se ZPV-ja duhet të bëjë përpjekje për të siguruar këtë lloj dokumentacioni përpara dërgimit të raportit të saj Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në mënyrë që të shmangë, për aq sa është e mundur, vonesat e shkaktuara nga parashtrimet plotësuese dhe/ose shtyrja e vendimeve. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPV-së se, nëse sipas mendimit të saj është e qartë që një kërkesë nuk ka lidhje me akuzat e konfirmuara, ZPV-ja gjithsesi duhet të sigurojë përmbushjen e kritereve sipas pikave (i)-(iv) dhe (vi).<sup>29</sup>

#### **4. Ndarja në grupe e parashtruesve të kërkesave për pjesëmarrje si viktimë**

21. Në lidhje me ndarjen në grupe dhe përfaqësimin juridik të parashtruesve të kërkesave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në lidhje me raportin e parë, ZPV-ja i dorëzoi rekomandimet e saj veç e veç dhe njërin pas tjetrit,<sup>30</sup> ndërsa në lidhje me raportin e dytë, rekomandimet përkatëse u dorëzuan së bashku me raportin.<sup>31</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në që t'i dorëzojë rekomandimet njëkohësisht me raportet e ardhshme, siç u bë në rastin e raportit të dytë, në mënyrë që të shmangen vonesat e shkaktuara nga parashtrimet plotësuese.

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të rregullës 113(7) të Rregullores, Administratori i cakton një mbrojtës një grupi viktimash pjesëmarrëse në proces. Kur vendos për caktimin e mbrojtësit të viktimave, Administratori duhet të marrë parasysh, mes të tjerash, pikëpamjet dhe interesat e viktimave, në përputhje me pjesën 15 të Direktivës për Mbrojtësit. Në rastin në fjalë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se si në raportin e parë ashtu edhe në raportin e dytë, ZPV-ja deri më tani ka informuar nëse parashtrues të veçantë të kërkesave për pjesëmarrje si viktimë kishin ndonjë parapëlqim për ndonjë përfaqësues juridik të veçantë. Në raste

---

<sup>29</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 23.

<sup>30</sup> Parashtrimi plotësues, para. 11-32.

<sup>31</sup> Raporti i dytë, para. 38-44.

të tilla, ZPV-ja duhet të verifikojë gjithashtu: (i) nëse parashtruesi i kërkesës është përfaqësuar nga një mbrojtës në procedimet e kaluara që lidhen me çështjen përkatëse para DHSK-së, dhe nëse është kështu, nëse parashtruesi i kërkesës ka ndonjë pritshmëri që të përfaqësohet nga i njëjti mbrojtës para DHSK-së; dhe (ii) ndërsa informon parashtruesin e kërkesës se pikëpamjet e tij apo të saj përbëjnë vetëm një prej aspekteve që mbahen parasysh nga Administratori për caktimin e mbrojtësit të viktimave, ZPV-ja verifikon nëse parashtruesi i kërkesës ka shqetësime në lidhje me caktimin e mundshëm të një përfaqësuesi juridik të ndryshëm nga ai që parashtruesi do të kishte parapëlqyer, dhe nëse po, cilat janë ato. Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në të dorëzojë përgjigjet e dhëna bashkë me rekomandimet e saj.

## B. FORMULARI ELEKTRONIK I KËRKESËS

23. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në kërkesën e saj ZPV-ja ka ngritur këto çështje: (i) përshtatshmëria e një formulari elektronik për kërkesat për pranim si viktimë; (ii) mundësitë e tjera përveç nënshkrimit me dorë të formularit të kërkesës; dhe (iii) lidhja ndërmjet formularit të kërkesës dhe barasvlerësit elektronik të tij.

24. Për sa i përket përshtatshmërisë së formularit elektronik për parashtrimin e kërkesave për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se paraqitja e një formulari të tillë është një ndërmarrje e dobishme dhe në kohën e duhur, duke pasur parasysh zgjerimin e përdorimit të mundësive elektronike në proceset gjyqësore dhe administratën publike. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se përveç formularit tradicional të kërkesës, parashtruesve të kërkesave për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces duhet t'u vihet në çdo kohë në dispozicion edhe formulari elektronik i kërkesës dhe se nuk është e nevojshme që parashtruesi i kërkesës të japë arsye për përdorimin e tij. Përkundrazi, dhe me synimin për të lehtësuar angazhimin e viktimës, parashtruesi i kërkesës duhet

të ketë mundësi të zgjedhë që ose të plotësojë me dorë formularin e kërkesës, ose të përdorë versionin elektronik të tij.

25. Për sa i përket mundësive të tjera përveç nënshkrimit me dorë të formularit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se një nga kriteret për një formular të plotë kërkesë, siç përcaktohet në vendimin e parë kornizë, është që kërkesa të nënshkruhet nga parashtruesi i kërkesës ose nga kujdestari i tij/saj ligjor.<sup>32</sup> Duke marrë parasysh nevojën për të identifikuar parashtruesit e kërkesave dhe për të provuar vërtetësinë e formularëve të tyre, por duke mbajtur gjithashtu parasysh praktikat e sotme në Kosovë lidhur me nënshkrimin e dokumenteve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nënshkrimi në formularin e kërkesës mund të jetë: (i) i shkruar me dorë (parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor shkruan emrin e tij/saj ose vë një shenjë në dokumentin fizik të formularit të kërkesës); ose (ii) elektronik (parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor përdor nënshkrimin e tij apo të saj të përfutur në mënyrë digjitale, ose vendos apo bashkëngjit në kopjen elektronike të formularit të kërkesës një pamje digjitale të nënshkrimit (kopje të skanuar, fotografi të bërë, për shembull, me telefon celular) ). Gjykatësi i Procedurës paraprake gjykon që, si nënshkrimet me dorë, ashtu edhe ato elektronike të përshkruara më lart mund të pranohen si të vlefshme.

26. Lidhur me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPV-ja propozon të hiqet kriteri i vënies së nënshkrimit në formularin e propozuar dhe ai të zëvendësohet me pjesën e konfirmimit solemn të ndjekur nga emri në formë të shtypur i parashtruesit të kërkesës.<sup>33</sup> ZPV-ja pohon se në çdo rast parashtruesit të kërkesës do t'i kërkohet të dorëzojë një kopje të një dokumenti identifikimi dhe se ndërthurja e konfirmimit solemn dhe dëshmisë së identitetit ofron një mënyrë të besueshme për garantimin e vërtetësisë.<sup>34</sup> Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se

---

<sup>32</sup> Vendimi i parë kornizë, para. 22.

<sup>33</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 16.

<sup>34</sup> Kërkesa e ZPV-së, para. 17.

dorëzimi i kopjes digjitale të një dokumenti identifikimi kërkon që të kryhen të njëjtat veprime elektronike si në rastin e bashkëngjitjes së pamjes digjitale të nënshkrimit të bërë me dorë. Rrjedhimisht, nëse parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor është në gjendje të plotësojë dhe dërgojë formularin elektronik të kërkesës dhe të dërgojë një kopje digjitale të dokumentit të identifikimit të tij apo saj, ai ose ajo duhet të jetë në gjendje gjithashtu të dorëzojë ose bashkëngjisë pamje digjitale të nënshkrimit të tij ose saj.<sup>35</sup> Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është e drejtë të ruhet kriteri i vënies së nënshkrimit, qoftë me dorë apo në mënyrë elektronike.

27. Sa i përket lidhjes ndërmjet formularit të kërkesës dhe barasvlerësit elektronik të tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në mënyrë që të sigurohet përputhja midis formularit të kërkesës dhe formularit të propozuar, ZPV-ja duhet të krijojë një formular të njësuar që të mund të përdoret si në rastet e kopjeve fizike, ashtu edhe për ato elektronike (“formulari i njësuar”). Pjesa e nënshkrimit në formularin e njësuar duhet të përfshijë:

- a) një konfirmim të ngjashëm më atë të formularit të kërkesës;<sup>36</sup>

<sup>35</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se jurisprudenca e ICC/GJPN-së e cituar nga ZPV-ja për të mbështetur kërkesën e saj për heqjen e kriterit të vënies së nënshkrimit kishte të bënte me qasjen e përdorur në një çështje të veçantë për shkak të gjendjes së paqëndrueshme të sigurisë në Sudan, nivelit të ulët të shkrimit dhe leximit të parashtruesve të kërkesave për pjesëmarrje si viktimë në proces dhe mungesës së traditës së nënshkrimit fizik të dokumenteve. *Shih ICC, Prosecutor v. Ali Muhamad Ali Abd-Al-Rahman (“Ali Kushayb”), Registrar, Public Redacted version of “Registry Request for Authorization to use a Modified Standard Application Form to Facilitate Victim Participation in the Case”, 8 October 2020, ICC-02/05-01/20-178-Conf, ICC-02/05-01/20-178-Red, 2 nëntor 2020, para. 6-9, poshtëshënimi 9.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se gjendja në Kosovë nuk mund të krahasohet me rrethanat e lartpërmendura.

<sup>36</sup> Pjesa e konfirmimit në formularin e kërkesës ka këtë përmbajtje:

“Unë konfirmoj se:

- kam mundur ta lexoj këtë formular kërkesë për pjesëmarrje në proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara të Kosovës në një gjuhë që e kuptoj ose, nëse jo, formulari më është lexuar në një gjuhë që e kuptoj;
- më poshtë kam vënë nënshkrimin tim, si dhe kam vënë inicialet e mia në çdo faqe të këtij formulari dhe të dokumenteve mbështetëse;
- informacioni i dhënë në këtë formular është i saktë me sa kam dijeni.”

Formulimi në lidhje me vënien e inicialeve në çdo faqe të formularit dhe të dokumenteve mbështetëse mund të hiqet nga pjesa e konfirmimit për rastet kur nënshkrimi vihet në mënyrë elektronike.

- b) datën dhe vendin e nënshkrimit;
- c) mundësinë për ta nënshkruar formularin e kërkesës me dorë, siç në formularin e tanishëm të kërkesës;<sup>37</sup>
- d) mundësinë për të nënshkruar formularin e kërkesës në mënyrë elektronike, ku parashtruesit të kërkesës i ofrohet zgjedhja për të bashkëngjitur pamjen digjitale të nënshkrimit; dhe
- e) udhëzimin për të bashkëngjitur, dorëzuar ose ngarkuar një kopje fizike ose elektronike të dokumentit të identifikimit të parashtruesit të kërkesës dhe/ose kujdestarit ligjor.

28. Marrja e nënshkrimit në mënyrat e përshkuara më lart mund të bëhet edhe pas dorëzimit të formularit përkatës nga parashtruesi i kërkesës dhe ZPV-ja mund t'u ofrojë ndihmë parashtruesve të kërkesave në lidhje me këtë. Formulari i kërkesës që i dorëzohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, përmban në çdo rast nënshkrimin e kërkuar.

## V. VENDIM

29. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **UDHËZON** ZPV-në të veprojë në përputhje me sqarimet e dhëna në paragrafët 16-22; dhe
- b. **URDHËRON** ZPV-në të hartojë dhe përdorë formularin e njësuar, siç përcaktohet në paragrafët 24-28.

---

<sup>37</sup> Pjesa 6 (Nënshkrimi) i formularit të kërkesës përmban: (i) konfirmimin; (ii) listën e dokumenteve të bashkëngjitura dhe numrin e faqeve; (iii) datën dhe vendin; dhe (iv) nënshkrimin me dorë.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatësi Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E martë, 6 korrik 2021

Në Hagë, Holandë.